

Albanian Alps Institute  
1620 NW 23<sup>rd</sup> Street  
Corvallis, OR 97330

Phone: 541-753-3066  
Email: [albanianalpsinst@gmail.com](mailto:albanianalpsinst@gmail.com)  
Website: [www.albanianalps.org](http://www.albanianalps.org)

President: Steve Cook, PhD


Secretary: Terri Cook

Board of Directors:

Karen Berg  
Sharon Carlson  
Mary Alice Seville  
Nancy Leeper  
Alcyon Lord  
Kristina Milaj

Albania Manager:  
Marash Rakaj

## TAIWANESE STUDENT VOLUNTEERS



Per here te pare ne historine e Vrithit dy gra Taivaneze udhetuan ne fshat per te dhene mesim ne gjuhen angleze te te folurit nen programin vullnetar te AAI.. Ato ndenjen me mamane time, Violeta Milaj, dhe une isha shoqeruesja dhe perkthyesja. Njerezit ne fshat me pyesnin vazhdimisht “pse kane ardhur ato ketu?” Kla dhe Yi-ning jepnin mesim ne mengjez ne Vrithe dhe ne mbasdite shkonin ne Xhaj. Mesuesi i anglishtes i AAI , Aleks Vulaj bente transportin midis fshatrave. Ne kohen e lire, ngjiteshim neper male, vizitonim kishen, dhe fshatrat rreth e rrotull. Ato ishin shume kurjoze per menyren e jeteses tone, ushqimin, kulturen, dhe kishin qef te merrnin fotografi njerezit duke punuar ne kopshtete e tyre e rredh fshatit. Jeta e fshatit ishte shume e ndryshme nga jeta e tyre ne Tajvan. Na pelqeu shume metoda e tyre e mesimit te Anglishtes se ato perdornin vizatime dhe kenge per te na mesuar.

### Nje Fjale Nga Presidenti Steve Cook

Instituti i Alpeve te Shqiperise vazhdon te permiresoje edukimin e femijeve te Shkolles se Komunes se Shkrelit qe prej vitit 2003. Kemi pasur shume sukses ne hapjen e bibliotekave ne pese shkolla ku nuk ekzistonte asgje me pare.; kemi pajisur tre shkolla me mesuesa anglishteje; kemi dhene bursa per leke transporti ne shkollen e mesme; jemi duke ndihmuar kater kopeshte; dhe jemi duke mbuluar shpenzimet e nxenesave qe vazhdojne shkollen e mesme ne Shkoder(gjithashtu kemi dhene bursat vajzave te para qe vashdojne shkollen e mesme dhe kolegjin nga Vritha dhe Boga). Por 2013-14 duket viti yne me i veshtire. Dhurimet jane ulur seriozisht shume dhe ne kemi nevojte te madhe per fonde qe te vazhdojme programet tona me te domosdoshme. Per ata qe na kane ndihmuar ne te shkuaren, faleminderit, dhe ju lutemi te keni ne considerate nevojat tona kur te dhuroni perseri kete vit. Per ata qe nuk kane ndihmuar me pare, dua t’ju siguroj qe cdo fond shkon ne programet tona, ne nuk kemi shpenzime administrate apo zyre, une dhe gruaja ime Terri paguajme per ato shpenzime personalisht. Ne faqen e mbrapme do te gjeni letrat nga kater studentat tane qe marrin burse.

*Our Mission:  
Supporting improved quality of  
educational opportunities for  
the children and youth of the  
isolated Malesia e Madhe  
region of Northern Albania.*

Ndihma per mua nga AAI filloj qysh ne klasen e tete, kur ato paguan nje ndihmese qe te rrinte me mamane time qe ishte e semure. Kjo beri te mundur qe une dhe motra ime te vazhdonim shkollen e te mos mungonim asnje dite. Me ndihmen e AAI babai im vendosi te me dergonte ne shkollen e mesme ne Shkoder, nje enderr imja qe u be realitet. Une dhe shoqja ime Rexhina ishim nga vajzat e vetme nga Boga qe kishin lene shtepine per te vazhduar shkollen e mesme. Kjo ishte ne te njeten kohe sacrifice e madhe dhe nje eksperience e paharrueshme. Jam jashtezakonisht mirenjohese per ndihmen tuaj. Tani une po vazhdoj studimet universare per Psikologji. Kam deshire te madhe te filloj pune dhe te behem e dobishme ne shoqeri. Ndihma qe kam marre nga AAI ka pasur nje ndikim shume te madh jo vete ne edukimin tim por gjithashtu ne personalitetin tim, ka qene plotesimi i deshires sime me te madhe. Ndihma e AAI ka qene nje ndihme e pazevendesueshme dhe ka hapur rrugen per nje te ardhme me te mire per mua.

Dafina Rakaj



Qe kur isha femije, kisha nje enderr-te mbaroja Universitetin. Gjendja ekonomike e familjes time e bente kete enderr te pamundur. Por une mesoja shume dhe shpresoja per nje mbrekulli. U perpoqa ta harroja endrren...por faleminderit Zotit endrra nuk eshte enderr me, eshte realitet, sepse AAI me ndihmoi te vazhdoja shkollen e mesme e tani ne fund Universitetin e Shkodres ku vazhdoj studimet per Matematike.

Nuk ka fjale qe une te shpreh mirenjohjen per ndihmen e AAI. Por per nje gje jam e sigurt: une do te ndihmoj te tjeret kur te vije koha, ashtu si Profesor Steve dhe AAI me ndihmuan mua. Falenderoj nga zemra ata qe bene te mundur endrren time ne realitet, dhe do te punoj e mesoj shume qe ti bej ata krenare.

Toneta Durgaj

## RECIPIENTS



Bursa e AAI ka qene dhe mbetet nje nga arsyet kryesore qe une jam ne shkolle. Ju me keni mbeshtetur per tete vjet, ne shkolle te mesme e tani ne Universitet. Ju falenderoj nga zemra per ndihmen tuaj qe beri te mundur qe une tani te jem ne vitin e trete te Fakultetit Ekonomik, ne Departamentin e Biznesit. Shume faleminderit per kontributin tuaj.

Aurel Lekaj



Arsyeja e vetme qe une vazhdova shkollen e mesme eshte sepse Profesor Steve ja mbushi mendjen babait tim te pranonte bursen e AAI. Kjo burse pati tre kuptime per mua, mundesi, mbeshtetje dhe nxitje. Per tu bere dikush ne jete duhet te te jepet mundesia, te kesh mbeshtetje dhe nxitje per te ndjekur ate mundesi. AAI me dha mundesine per te mesuar--dicka qe kam patuar gjithmone deshire. Tani e kam mbaruar shkollen e mesme dhe po vazhdoj Universitetin e Shkodres, e gjithë kjo ne saj te ndihmes qe kam marre nga AAI. Kam patur nje enderr, te mesoj. Tani kjo enderr eshte realitet. Une tani po studioj lenden time te preferuar, Ekonomik-Finance. Ne jete asgje nuk eshte e lehte, por ne qofte se une punoj shume, nje dite do te behem dikush. Asnjehere nuk do te harroj se kush me dha doren e pare lart. Une i jam shume mirenjohese Profesor Stivit dhe AAI. Faleminderit shume.

Rregjina Rakaj

## Pionierja e Pare

Anetarja me e re e drejtorise se AAI eshte Kristina Malaj te cilen e kemi vene ne dukje ne pamfletin e meparshem. Kristina ishte bursarja e pare e AAI, vajza e pare nga fshati i saj qe vazhdoi shkollen e mesme, dhe Universitetin, dhe Shqipetarja e pare ne drejtorine tone. Ajo do diplomohet per Inxhinjeri te Ndertimeve Publike nga Universiteti i Shtetit te Oregonit ne pranvere te 2014. Nderkohe qe ajo mezi sa prët te gjeje nje pune dhe ndoshta te vazhdoje studimet per Masterin ne degen e saj, nje nga qellimet e saj ne jete eshte ne japi te tjerëve ate mundesi qe i eshte dhene asaj. Si anetare e AAI Kristina thote: "Qellimi im eshte te filloj bashkepunimin midis Shqiptareve qe rrojne ne Amerike dhe AAI per te bere nje investim te vogel ne nasurine me te cmuar te vendit tim- rinine e tii"



## PROGRAMET E AAI

- Bursa
- Libra per Biblioteka
- Mbeshtetje Per Kopshtet
- Programe Anglisht